

Forumi i Gjelbër i Parë Dokument zotimi Kosovo Green Action

Tetor 2024

Me nënshkrimin e Deklaratës së Sofjes për Agjendën e Gjelbër në nëntor të vitit 2020, Kosova u zotua të arrijë dekarbonizimin deri në vitin 2050. Ky zotim pasqyron aspiratat e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane dhe është i strukturuar rreth pesë shtyllave kryesore: (i) Veprimi klimatik, që përfshin dekarbonizimin, energjinë dhe mobilitetin; (ii) Ekonomia qarkore, duke adresuar menaxhimin e mbeturinave, riciklimin, prodhimin e qëndrueshëm dhe efikasitetin e burimeve; (iii) Ruajtja e biodiversitetit; (iv) Luftimi i ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës; dhe (v) Promovimi i sistemeve të qëndrueshme të ushqimit dhe zhvillimit rural.¹

¹ Regional Cooperation Council, Sofia Declaration on the Green Agenda for the Western Balkans, <https://www.rcc.int/docs/546/sofia-declaration-on-the-green-agenda-for-the-western-balkans-rn>

Sfondi

Për më tepër, Qeveria e Kosovës është zotuar të monitorojë pajtueshmërinë mjedisore, të lehtësojë pjesëmarrjen e publikut, të sigurojë qasje në informata dhe drejtësi për çështjet mjedisore, si dhe të përmirësojë mekanizmat e raportimit mjedisor.²

Ndonëse është shënuar përparim në ndërtimin e sistemeve përkatëse të qeverisjes dhe politikëbërjes, Kosova ende përballet me sfida në zbatimin efektiv të Agjendës së Gjelbër, siç është koordinimi i pamjaftueshëm ndërmjet organeve qeveritare, aftësitë e kufizuara vendimmarrëse të bazuara në të dhëna dhe mungesa e kapaciteteve për të hartuar dhe zbatuar politika të harmonizuara me Agjendën. Njëkohësisht, qytetarët e Kosovës kërkojnë rritje të transparencës, efikasitetit dhe llogaridhënies nga qeveria e tyre.³

Për të adresuar këto sfida është thelbësor krijimi i platformave me shumë akterë (MSP). Këto platforma ofrojnë mjedise të strukturuar për institucionet qeveritare, ndërmarrjet private dhe shoqërinë civile që të bashkëpunojnë, të adresojnë shqetësimet, të krijojnë zgjidhje së bashku dhe të rrisin transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve qeveritare.⁴

2 World Bank, Concept Environmental and Social Review Summary https://ewdata.rightsindevelopment.org/files/documents/84/WB-P179084_uRhepxD.pdf

3 USAID Kosovo, Accountability, <https://www.usaid.gov/kosovo/accountability#:~:text=Kosovo's%20citizens%20demand%20greater%20transparency,Government%20accountable%20to%20such%20demands>.

4 Siangulube, F.S. The Role of Multistakeholder Platforms in Environmental Governance: Analyzing Stakeholder Perceptions in Kalomo District, Zambia, Using Q-Method. Environmental Management <https://link.springer.com/article/10.1007/s00267-023-01806-z>

Hyrje dhe qëllimi

Në përgjigje të sfidave të lartpërmendura, Balkan Green Foundation në partneritet me Open Data Kosovo dhe Lëvizjen Fol implementojnë projektin Kosovo Green Action (KGAP), përmes mbështetjes së Partneritetit Global për Përgjegjshmëri Sociale, një fond i besueshëm me shumë donatorë i administruar nga Banka Botërore që lehtëson bashkëpunimin e organizatave të shoqërisë civile me qeveritë dhe angazhimin e qytetarëve me qëllim të zgjidhjes së problemeve të zhvillimit, forcimit të llogaridhënies dhe përmirësimit të qeverisjes së sektorit. KGAP është i përkushtuar ndaj avancimit të qasjes së publikut në informata përmes bashkëpunimit me shumë akterë, nxitjes së transparencës, rritjes së llogaridhënies dhe zbatimit të shërbimeve në përputhje me Agjendën e Gjelbër. Projekti ka tri komponentë, duke përfshirë: (1) zhvillimi dhe mbështetja e përgjegjshmërisë sociale bashkëpunuese; (2) angazhimi i akterëve dhe ngritja e kapaciteteve; dhe (3) menaxhimi i projektit, monitorimi, mësimi dhe shpërndarja e njohurive.

Ndër iniciativat kryesore të projektit është organizimi i tre “Forumeve të Gjelbra” vjetore, të cilët shërbejnë si një platformë funksionale për mbledhjen e komenteve dhe rekomandimeve të palëve të interesuara për zbatimin e Agjendës së Gjelbër. Kjo nismë vjetore synon të lehtësojë angazhime kuptimplotë bashkëpunimi që mund të çojnë në reforma më efektive të politikave dhe përmirësim të shërbimeve të ofruara. Proces i vazhdimësi siguron dialog të vazhdueshëm, duke rishikuar zotimet e dhëna nga përfaqësuesit qeveritar në vitet e mëparshme dhe duke ofruar një platformë për rekomandime bashkëpunuese për të ecur përpara.

Ky dokument zotimesh është një pjesë integrale e KGAP pas Forumit të Gjelbër të fundit i cili ishte mbajtur më 30 nëntor 2023 në Menza Ramiz Sadiku në Prishtinë. Forumi i Gjelbër i parë trajtoi temën “Përkushtimi dhe Progresi në Agjendën e Gjelbër në Kosovë”, me pjesëmarrës përfaqësues nga entitetet kyçe, duke përfshirë Ministrinë e Ekonomisë, Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Zyrën e Kryeministrit dhe GIZ-in. Ky dokument përshkruan zotimet e paraqitura nga institucionet qeveritare gjatë Forumit të Gjelbër, duke përforcuar përkushtimin e projektit ndaj transparencës, llogaridhënies dhe angazhimit të akterëve.

Zotimet e institucioneve qeveritare

Zyra e Kryeministrit luan një rol qendror koordinues në përpjekjet e Qeverisë së Kosovës për t'u integruar në Bashkimin Evropian, duke përfshirë negocimin dhe zbatimin e Agjendës së Gjelbër. Kjo agjendë përfshin detyrime dhe iniciativa të ndryshme, me përgjegjësi specifike të ngarkuara ministrive përkatëse të linjës. Ministria e Ekonomisë formulon politikat në fushën e energjisë, minierave, TIK-ut dhe ekonomisë digjitale, në përputhje me standardet e BE-së. Departamenti i Energjisë harton dhe monitoron politikat dhe legjislacionin e energjisë, promovon investimet për një furnizim të sigurt, të përballueshëm dhe të qëndrueshëm me energji, mbikëqyr performancën e sektorit dhe mbrojtjen e konsumatorëve, mbështet planifikimin komunal dhe koordinon bashkëpunimin rajonal. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës formulon politika në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, planifikimin hapësinor dhe zhvillimin e infrastrukturës miqësore ndaj mjedisit. Gjithashtu, mbikëqyr agjencitë brenda institucionit që merren me mbrojtjen e mjedisit.

Ky dokument përshkruan zotimet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke reflektuar rolin e tyre vendimtar në avancimin e zbatimit të Agjendës së Gjelbër.

**Ministria e
Ekonomisë
zotohet të**

- **Miratojë dhe fillojë së zbatuari Strategjinë e Energjisë 2022-2031 në përputhje me Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane dhe Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, duke siguruar konsistencë me draft Planin Kombëtar për Energji dhe Klimë (miratuar; zbatimi në vazhdimësi).**
- **Krijojë një kornizë ligjore për të adresuar sfidat për peizazhin e energjisë së pastër, me Ligjin për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE) që do të miratohet në TM2/2024 (e përfunduar).**
- **Zhvillojë ankande transparente dhe konkurruese për investime në BRE, duke përfshirë përmbylljen e ankandit solar 100 MW dhe shpalljen e fituesit në TM1/2024 (e përfunduar); Identifikojë lokacionet dhe përgatisë dokumentacionin për ankandet shtesë për projektet e energjisë së erës dhe solare (në zhvillim).**
- **Bashkëpunojë në projektin e baterisë për ruajtjen e energjisë, financuar nga Llogaria për Kosovën në Sfidën e Mijëvjeçarit (MCA) (në vazhdimësi).**
- **Të nis një projekt 150 MW për energji të erës duke përdorur fondet nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) për Reziliencë dhe Qëndrueshmëri (RSF) për të ndihmuar në prokurimin e këtij kapaciteti të erës prej 150 MW. Ministria e Ekonomisë (ME) do të përdorë fondet e RSF-së për të bashkë-investuar në projektet e ndara të erës sipas një skeme të Partneritetit Publiko-Privat (PPP), duke synuar të reduktojë rrezikun për investitorët privatë. Projektet e suksesshme do të shpërblehen me marrëveshje 15-vjeçare për blerjen e energjisë elektrike.**

-
- Zbatimi i tenderit të iniciuar për ndërtimin dhe funksionimin e një centrali solar 100 MW në tokë publike, i cili do të përdoret për qëllime tregtare dhe zhvillim energjetik.
 - Miratojë stimuj për efikasitet energjetik për sektorin privat dhe amvisëri, duke u përqendruar në aspekte sociale dhe familjet me të ardhura të ulëta (stimujt shtetërorë) dhe shfrytëzimin e programeve ekzistuese të BE-së në Kosovë (TM4/2024).
 - Finalizojë fazën e tretë të studimit gjithëpërfshirës mbi burimet alternative të qëndrueshme të energjisë në pajtim me tranzicionin e qëndrueshëm të gjelbër në Evropë, (TM1/2024).

**Ministria
e Mjedisit,
Planifikimit
Hapësinor dhe
Infrastrukturës
zotohet të:**

- Finalizojë dhe miratojë Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (TM4/2024).
- Miratojë Projektligjin për Ujërat e Kosovës (TM4/2024).
- Miratojë Planin e Veprimit për Cilësinë e Ajrit (TM4/2024).
- Dizajnojë masa të kontrollit të ndotjes së ajrit në Prishtinë dhe aglomeracione të tjera më të rëndësishme dhe zonat e ndjeshme (TM4/2024).

-
- Zhvillojë dhe nis së zbatuari një plan gjithëpërfshirës të zhvillimit të kapaciteteve institucionale për implementimin dhe zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e mbeturinave (TM4/2024).
 - Ndryshojë dhe plotësojë strategjinë kombëtare për menaxhimin e mbeturinave për të përfshirë objektivat e riciklimit, masat për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme, bashkëpunimin ndërkomunal (TM4/2024).
 - Transponojë në legjislacionin e Kosovës direktivat e BE-së për rrjedhën e mbeturinave (TM4/2024).
 - Organizojë fushata të ndërgjegjësimit të publikut (TM4/2023 dhe në vazhdimësi).
 - Implementojë strategjinë për ndryshime klimatike dhe planin e veprimit për ndryshimet klimatike.
 - Përgatitë një inventar të emetimeve të gazrave serë që mbulojnë periudhën deri në vitin 2021 (TM2/2023).

Konkluzioni

Si përfundim, përmes angazhimeve të tilla si krijimi i kornizave ligjore, kryerja e ankandëve për investime në energjinë e ripërtërishme dhe zbatimi i projekteve të energjisë së qëndrueshme, Kosova demonstroi përkushtimin e saj ndaj qëndrueshmërisë mjedisore. Megjithatë, suksesi në arritjen e Agjendës së Gjelbër kërkon përgjegjësi kolektive nga të gjithë aktoret. Duke nxitur angazhimin e akterëve dhe duke monitoruar sentimentin, ne mund të identifikojmë dhe t'u japim prioritet çështjeve mjedisore dhe sociale, duke siguruar që zgjidhjet janë zhvilluar për të përmbushur nevojat e tyre në mënyrë efektive. Me përpjekje bashkëpunuese dhe masa proaktive, Kosova mund të hapë rrugën drejt një të ardhmeje më të gjelbër dhe më të qëndrueshme për të gjithë.

Forumi i Gjelbër i ardhshëm do të trajtojë zotimet e mëparshme dhe zbatimin e tyre.

